

Berat Bekir Özipek<sup>1</sup>

UDC:  
329.11:316.75

## THEMELET E POLITIKËS KONSERVATORE<sup>2</sup>

### ТЕМЕЛИТЕ НА КОНЗЕРВАТОРНАТА ПОЛИТИКА

### THE FOUNDATIONS OF CONSERVATION POLICY

#### Abstract

Conservatism as a political ideology, like all other ideologies, has an authentic worldview on politics. Thus, conservatism as a political ideology unlike liberalism in the sphere of individual politics and its reason does not entail an absolute role. According to conservative ideology, man is a being with limited intellectual capacities and so it is not reasonable to have absolute faith in his ration.

Si e sheh politikën konservatorizmi; si një ideologji apo traditë mendimi, çfarë politike parashikon dhe cilat janë specifikat themelore të cilët e veçojnë konservatorizmin nga ideologjitë politike konkurrenente të saj? Tema e punimit tim mëton t'u përgjigjet pyetjeve të nevojshme me qëllim të përkufizimit të politikës konservatore.

Për ta kuptuar politikën e përvetësuar nga konservatorizmit, para së gjithash është e nevojshme shqyrtimi i sfondit filozofik i cili përcakton botëkuptimin e tij ndaj politikës si dhe shqyrtimi i pikëpamjeve themelore të tij ndaj njeriut, shoqërisë dhe botës. Një qasje e tillë kundrejt kësaj çështjeje, edhe pse në shikim të parë shumë qëndrime politike duken të paqëndrueshme, sërish politikat konservatore të cilat janë aplikuar historikisht, por edhe aktualisht, pavarësisht se a janë pozitive apo negative, në të shumtën e rasteve gjenden në një harmoni brenda tyre. Prandaj, nëse do të kishim ndjekur hap pas hapi tërësinë e

---

<sup>1</sup> Autori është ligjërues në Universitetin Medipol İstanbul.

<sup>2</sup> Ky punim është botuar në Revistën "Liberal Düşünce", Nr: 34, 2004.

pikëpamjeve të cilët shtrihen nga epistemologjia konservatore deri tek idetë politike, atëherë shpërfaqet logjika në vijim:

1. Sipas konservatorëve njeriu është një qenie e kufizuar dhe e papërsosur; posedon një kapacitet të kufizuar racional dhe vetvetiu nuk posedon njohuritë e nevojshme për të zgjidhur sekretin e universit dhe shoqërisë në të cilën jeton ai. Bota është shumë më e komplikuar se sa mund ta kuptojë arsyeja njerëzore. Kjo qasje e konservatorizmit, në esencë, shpreh një kritikë ndaj arsyes iluministe. Ky botëkuptim konservator për njeriun e papërsosur ka burimet e tij fetare dhe laike. Por pika e përbashkët e të gjithëve është se, edhe përkundër optimizmit të iluminizmit, arsyeja njerëzore nuk mund të jetë një subjekt konstituiv.

2. Nisur nga këtu, konkluzioni i dytë në të cilin do të arrihet është nevoja për një qasje skeptike ndaj pretendimit se njeriu individual si një qenie me kapacitete të kufizuara racionale posedon dijen e nevojshme për të krijuar një shoqëri ideale apo një botë ideale. Konservatorët, dijen njerëzore, veçmas duke insistuar në pamjaftueshmërinë e dimensionit në lidhje më botën politike dhe sociale, theksojnë mungesën e elementit kognitiv perfeksionist të njeriut (Müller, 1997: 1-2). Sipas Müller kjo “modesti epistemologjike” gjendet në skepticizmin filozofik të Hume-it, besimin fetar të Burke-s dhe Maistre-së me të cilin dija njerëzore është e kufizuar, si dhe në qasjen e Hayek-ut dhe Banfield-it në lidhje më pamjaftueshmërinë kognitive të njeriut.

3. Njeriu individual si një qenie e kufizuar nga natyra dhe vetë karakteri i tij mund ta fitojë kuptimin e vërtetë vetëm brenda një shoqërie. Ndërsa vlerat dhe institucionet të cilët përbëjnë shoqërinë duke mos qenë prodhim i dizajnit të vetëdijshëm të njeriut, në masë të madhe janë formuar brenda një procesi spontan dhe tek ata ekziston një dije e cila është prodhim i përvojës njerëzore. Konservatorët, ndryshe nga liberalët, shikuar nga aspekti metodologjik, nuk e shohin individin më një sy ontologjik i cili mund që vetvetiu të krijojë një ideologji, por sipas tyre individi liberal është një qenie fiktive e zhveshur nga përkatësia shoqërore. Individi kuptimësohet vetëm në masën e marrëdhënieve të cilët i ka me institucionet siç janë familja, religjioni dhe vlerat e përgjithshme. Institucionet të cilat kanë një kontinuitet historik nga e kaluara në të ardhmen, veçmas familja, është ajo që plotëson aspektet të cilat i mungojnë individit. Ndërsa sipas Thomas Fleming-ut, familja është ajo që individin i cili nuk është perfekt, e maturon, i jep identitetin

e vërtetë si dhe i jep ndjenjën e së kaluarës dhe të ardhmes. *“Individët janë qenie që harrojnë, ndërsa familja ka kujtesën e saj”* (1990: 13).

4. Nuk është e vështirë të parashikohet logjikisht se çfarë politike do të ndjek një mendësi e cila niset nga paragjykimi se njeriu posedon kapacitete të kufizuara, racionale dhe se dija njerëzore nuk është dije perfekte. Nëse njeriu nuk ka kapacitete intelektuale dhe mendore për të kuptuar individin dhe shoqërinë dhe nëse njeriu është i pavarur nga institucionet siç janë familja dhe religjioni si dhe nga vlerat siç është tradita, atëherë kjo do të thotë që ai nuk posedon as dijen e nevojshme për të bërë një politik me të cilën do duhej të krijohej një shoqëri plotësisht të re. Konservatorët, nuk janë kundër arsyes në politikë, por janë kundër racionalizmit. Prandaj, duke projektuar një model të shoqërisë ideale, ata nuk mundë ta pranojnë idenë revolucionare për transformimin e shoqërisë nëpërmjet autoritetit dhe racionalizmit. Kjo qasje shpreh një preferencë politike e cila buron nga thënia e Burke-s dhe kritika e tij ndaj revolucionit se, *“një revolucion është burimi fundit i të arsyeshmes dhe të mirës”*. Po ashtu kjo qasje buron edhe nga kritika e shumicës së konservatorëve ndaj Revolucionit Sovjetik.

Nëse do ta kishim përmbledhur këtë pikëpamje logjike, njeriut është një qenie e kufizuar dhe duke u bazuar në këtë, edhe kapacitetet intelektuale dhe racionale të tij janë të kufizuara. Duke qenë se njeriu individual i cili i vetëm është një qenie e mangët, ai mundë të kuptimësohet vetëm nëpërmjet vlerave dhe institucioneve të cilët mund ta përqafojnë dhe përbrendësojnë atë. Ne nuk mund ta dimë me siguri nevojën, rëndësinë dhe kuptimin e vlerave siç janë tradita, religjioni dhe familja, të cilat nuk janë produkt i projeksionit të vetëdijshëm të njeriut. Duke injoruar mençurinë e pandarë në këto institucione dhe vlera që meritojnë të vlerësohen dhe të mbahen, duke i bërë ato objekt i veprimtarisë politike mund të sjellin pasoja të paparashikueshme; dhe kështu politika duhet të krijohet si një hapësirë e kufizuar dhe modeste e ngjarjeve. Kritika e konservatorëve ndaj racionalizmit në politik, në të njëjtën kohë sjellë edhe mbrojtjen e paragjykimeve, traditës, autoritetit dhe të kaluarës. Sipas Burke-s, rregullimi i jetës së njeriut vetëm sipas arsyes së kulluar dhe mospërputhja e saj me traditën, të kaluarën dhe autoritetin është pasojë e qasjes racionaliste dhe iluministe. Prandaj Burke, kritikon racionalizmin dhe iluminizmin.

Sipas konservatorëve, roli i qeverisë, *“nuk është imponimi i preferencave shoqërisë, por është i kufizuar me ruajtjen e paqes”* (Sigler, 1968: 21). Sipas Oakeshott (1975: 42), *“roli i qeverisë nuk është*

*imponimi i besimit të ndryshëm të njerëzve të cilët i janë nënshtruar asaj. Po ashtu nuk është roli i saj as edukimi, orientimi apo bërja e tyre më të lumtur. Roli i saj nuk është as edhe koordinimi i tyre (qytetarëve), por detyra e qeverisë është vendosja e ligjit dhe rendit”.*

Theksi i konservatorizmit ndaj politikës pragmatike dhe anti-doktrinale, nuk nënkupton shpërfilljen e parimeve në politikë. Sipas Burke-s, parimet në politikë janë të rëndësishme dhe një shtetar i cili ka humbur parimet do të përcaktohet nga situatat dhe kushtet, ndërsa një shtetar i cili shpërfillë këtë situatë dhe këta kushte jo vetëm që është duke bërë gabim, por ai do të konsiderohet si një i çmendur (Harbour, 1982: 58-9). Kuptimi i kësaj qëndron në atë se, në praktikën politike teoria është e nevojshme dhe rëndësishme, por se ajo duhet të përkrahet nga praktika. Francis Canavan, thekson se Burke në këtë mënyrë krijojë lidhjen ndërmjet praktikës dhe teorisë. *“Arsyeja spekulative nuk mund t’u përgjigjet pyetjeve praktike”*, dhe në momentin kur njeriu nuk mund t’u përgjigjet pyetjeve në lidhje me teorinë dhe praktikën, atëherë mjeti kryesor i arsyes njerëzore është mendjehollësia (Harbour, 1982: 61-62).

Shikuar nga aspekti konservator, qeveria është e nevojshme për shkak se natyra e njeriut nuk është perfekte. Por rezultatet politike në të cilat konservatorët kanë arritur duke u bazuar në këtë mangësi nuk janë të njëjta. Ndryshe nga konservatorët Maistre dhe Mosher të cilët janë të ndikuar nga regjimet gjysmë-feudale dhe monarkike, Burke dhe konservatorët anglezë të cilët ndjekin atë, kanë mbështetur kushtetutën dhe qeverisjen parlamentare (Vincent, 1992: 75). Në këtë drejtim dhe në këtë mënyrë konservatorizmi, i cili në masë të madhe është konservatorizëm i botës anglo-amerikane, ngërthen një veçori lehtësuese për demokracinë. Por është e nevojshme të mos bëhen përgjithësime optimiste në këtë drejtim, sepse në këtë aspekt nuk ekziston një konservatorizëm homogjen. Mënyra demokratike dhe antidemokratike të cilët ekzistojnë në ideologjitë e tjera, po ashtu janë prezente edhe tek konservatorizmi. Një kritikë e cila bëhet shumë shpesh ka të bëjë me theksin e veçantë të konservatorizmit ndaj autoritetit dhe karakteri negativ i kësaj ideologjie kur është në pyetje demokracia. Po ashtu kur janë në pyetje të drejtat e njeriut kritikën e liberalëve ndaj konservatorëve janë të arsyeshme. Dhe në të vërtetë, në shumë vende të botës politikën liberale dhe paternaliste të cilët pretendojnë se ruajnë traditën, familjen dhe religjionin mbajnë vulën e qeverive konservatore.

Ndërsa sipas akademikëve dhe mendimtarëve të cilët mbrojnë se theksi i konservatorizmit ndaj autoritetit nuk mund të sjellë në një autoritarizëm absolut, nuk duhet kuptuar në formën e përdorimit të pushtetit të pakufizuar. Ashtu siç potencon Macridis (1988:80), konservatorizmi, *“nuk është një ideologji që mbështet akumulimin e pushtetit në duart e një personi dhe grupi të caktuar, një ideologji kundër lirive politike dhe individuale, një ideologji që refuzon të gjitha format e qeverisjes, që mbështet përdorimin e dhunës dhe shtypjes... nuk është as ideologji që mundë të krahasohet me autoritarizmin”*. Sepse mendimi për kufizimin e autoritetit politik është njëri nga argumentet kryesore të konservatorizmit. Autoriteti politik është vetëm njëri nga autoritetet që gjenden në shoqëri.

Qëndrimi i përgjithshëm i konservatorizmit anglez dhe amerikan mund të përkufizohet si *“mbrojtja e shtetit i kufizuar nëpërmjet dominit të ligjit dhe jopëlqimit të asaj që është doktrinë dhe dogmatike”* (O, Sullivan, 1994: 53). Shembulli më konkret i këtij qëndrimi mund të shihet në jetën e Burke-s. Sipas Russell Kirk, *“urrejtjen që ndjente për përdorimin arbitrar të forcës, Burke e përjetoi brenda katër ndodhive të rëndësishme në jetën e tij. Këto janë përpjekjet për t'u pajtuar me kolonitë amerikane, pjesëmarrja e George III në luftën kundër sundimit të Rockingham Whig-ut, rasti i Warren Hastings dhe rezistenca e ashpër ndaj doktrinës së armatosur, domethënë Jakobizmit”*. Thënë shkurt, ashtu siç brenda konservatorizmit ekzistojnë tradita autoritare, po ashtu ekzistojnë tradita të cilët fuqizojnë dhe konsolidojnë demokracinë dhe duke filluar nga Burke deri tek Kirk-u, konservatorizmit anglo-amerikan është në një linjë me këta dy mendimtarë.

Në këtë kontekst, rezultati ku do të arrijmë është se politika konservatore, është një rezultat i natyrshëm i paragjykimeve themelore filozofike në lidhje me shoqërinë dhe njeriun. Po ashtu, duke pasur parasysh se politika është një fushë e kufizuar aktiviteti, edhe aktivitetet e qeverisjes të cilët janë utopike dhe premtojnë parajsën në botë janë të panatyrshme. Politika konservatore, ndryshe nga politika racionaliste e cila është e pavarur nga tradita, religjioni dhe historia, mbron një politikë e kufizuar e cila parashikon një ndryshim sistematik dhe evolutiv. Pra, politika konservatore kërkon që në të gjitha ndryshimet të merret parasysh institucioni i familjes dhe vlerat siç janë religjioni dhe tradita.

Në fund, ajo që duhet theksuar është se, në ditët e sodit, duke u bazuar në botëkuptimet dhe partitë konservatore në vendet më të mëdha në botë siç janë SHBA-të, duhet të them se nuk duhet sjellë një

konkluzion të përshpejtuar në kuptimin që duhet ndjekur tradita e të menduarit konservatorë në kuptimin bashkëkohorë. Lëvizja neo-konservatore e cila sot dominon politikën në SHBA është vetëm njëra nga lëvizjet në politikën amerikane dhe rëndësia e saj qëndron në përfaqësimin e ngjyrës dominuese sa i përket politikës praktike. Kjo lëvizje traditën politike të maturuar dhe kufizuar të konservatorizmit klasik arrin ta përbrendëson vetëm në nivel diskursial, por në rrafshin praktik kësaj lëvizjeje mund t'i ngarkohet një rol të ekzagjeruar. Në politikën e jashtme dhe në luftën e fundit (Lufta në Irak) pamë që neo-konservatorizmi ka mbajtur një qëndrim anti paqësor. Prandaj, duke u përpjekur për të kuptuar politikën konservatore, është e nevojshme të mos harrohen ngjyrat e saja të ndryshme, traditat e ndryshme dhe ndjeshmëritë e ndryshme. Sidomos ata që përpiqen të krijojnë një traditë janë më të përgjegjshëm për këtë.

**Përkthyes: Murat M. Aliu**

#### **BIBLIOGRAFIA**

Burke, Edmund, *Reflections on the Revolution in France*, Ed. Thomas H. D. Mahoney, Bobbs-Merrill, Indianapolis, Yedinci Basım, (Oriijinal Basım 1790), New York, 1955.

Fleming, Thomas, "The Facts of Life", *Chronicles*, Vol. 14, No. 10, October 1990, ss. 12-15

Harbour, Eilliam R., *The Foundations of Conservative Thought*, University of Notre Dame Press, Notre Dame, 1982

Macridis, Roy C., *Contemporary Political Ideologies – Movements and Regimes-*, Harper Collins Publishers, Dördüncü Basım, New York, 1992

Muller, Jerry Z. (Ed.), *Conservatism -An Anthology of Social and Political Thought from David Hume to the Present-*, Princeton University Press, Princeton, 1997

Oakeshott, Michael, *Rationalism in Politics and Other Essays*, Liberty Press, London, 1991

O'Sullivan, Noël, "Conservatism", *Contemporary Political Ideologies* (Eds. Roger Eatwell and Anthony Wright), Pinter Publishers, London, 1994, pp. 50-77

Özipek, Bekir Berat, *Muhafazakarlık: Akıl, Toplum ve Siyaset*, Liberte Yayınları, Ankara, 2004.

Sigler, Jay A., "Political Thought of Michael Oakeshott", *Neë Individualist Review*, Vinter 1968, Vol. 5, No. 1, 17-22

Vincent, Andrew, *Modern Political Ideologies*, Blackwell, Oxford and Cambridge, 1992